



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

Numri i lëndës: 2019:222309  
Datë: 14.03.2024  
Numri i dokumentit: 05452663

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Durim BALAJ, në çështjen kontestimore të paditësve F.S., P.S., D.B., I.S., që të gjithë nga Gjakova, të cilët me autorizim i përfaqëson Teki Bokshi, avokat në Gjakovë, kundër të paditurve I.S., ish nga Prishtina, M.S., nga Prishtina të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Sokol Dobruna, avokat në Gjakovë, R.S., ish nga Gjakova, G.H., N.P., që të dyja nga Gjakova, dhe C.S., nga Franca, me objekt kontesti: vërtetim pronësie, jashtë shqyrtimit, me 14 mars 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. NDËRPREHET procedura kontestimore e udhëhequr sipas shenjës 2019:222309, për shkak të vdekjes së të paditurit I.S. ish nga Prishtina.

II. Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e të paditurit I.S. ish nga Prishtina, e marrin përsipër procedurën apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

A r s y e t i m

Paditësit F.S., P.S., D.B., I.S që të gjithë nga Gjakova, kanë parashtruar padi në këtë gjykatë me datë 11.12.1995, kundër të paditurve I.S., ish nga Prishtina, M.S., nga Prishtina, R.S., ish nga Gjakova, G.H., N.P., që të dyja nga Gjakova, dhe C.S., nga Franca, me objekt: vërtetim pronësie.

Gjykata ka caktuar seancën përgatitore në këtë çështje për datë 04.03.2024, mirëpo në fletë kthesën për dorëzim personal të dorëzuar më Postën e Kosovës, qëndron konstatimi se “personi ka vdek”, konstatim i cili i referohet të paditurës R.S., si dhe nga ana e të autorizuarit të të paditurit I.S., në seancën e datës 04.03.2024, u dha deklarimi se i njëjti ka vdekur.

Gjykata pas marrjes se informacionit lidhur me faktin e vdekjes, i është drejtuar Komunës së Gjakovës për të kërkuar informacion lidhur me faktin e vdekjes për të paditurit I.S., dhe R.S, e cila më datë 04 mars 2024, përmes e-mailit zyrtar ka bashkëngjitur certifikatën e vdekjes për të paditurin I.S., me numër reference 19/2023RV/19001, me numër rendor 2269, të datës 04.03.2024, si dhe ekstraktin nga regjistri qendror i gjendjes civile për R.S., me numër serik E 27766220, të datës 04.03.2024, pasi që vdekja e kësaj të fundit nuk është e regjistruar në regjistrin zyrtar.

Andaj, gjykata referuar faktit të theksuar në seancën përgatitore për vdekjen e të paditurve, e në kuptim të nenit 277 pika (a) të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilin është paraparë se: *“Procesi gjyqësor ndërpritet: a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale, e nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim”*, vendosi që ta ndërpres procedurën kontestimore në këtë çështje juridike kontestimore, pasi që me certifikatën e vdekjes me numër të referencës 19/2023RV/19001, me numër rendor 2269, të datës 04.03.2024, e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë, u provua fakti i vdekjes për të paditurin.

Procedura në këtë çështje juridike do të vazhdoj kur trashëgimtarët e të paditurit I.S. ish nga Prishtina, e marrin përsipër procedurën apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

Andaj gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

2019:222309, me 14 mars 2024

G J Y Q T A R

Durim BALAJ

### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas marrjes së të njëjtit në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj Gjykate.